

Historitë e Vështira dhe Identitetet Pozitive

“Historitë e vështira” është studim që ofron analiza të vlefshme dhe pyetje në lidhje me të mësuarit e historisë nëpër shkolla. U drejtohet në radhë të parë mësuesve dhe lexuesve britanikë por jo vetëm. Përmban këshilla të rëndësishme dhe, mbi të gjitha, pyetje për krejt mësuesit anembanë, si dhe shembuj interesantë nga bota. Është veçanërisht i rëndësishëm për vendet e pasluftës.

Siç shkruan në Parathënien e raportit: ...Ky Raport i Cumberland Lodge-it shënon kulmin e një projekti dymbëdhjetëmuajsh për të hulumtuar trashëgiminë e aspekteve të theksuara të “vështira” të historisë së Mbretërisë së Bashkuar, në lidhje me identitetet bashkëkohore dhe me format e përkatësisë. Ai përdor njohuritë dhe përvojën e akademikëve, të edukatorëve, të kuratorëve të muzeve, të përfaqësuesve të organizatave joqeveritare (OJQ), të politikëbërësve dhe të të rinjve. Historitë e Vështira & Identitetet Pozitive ofron një kuptim ndërdisiplinor dhe ndërsektorial në atë se si aspektet e së kaluarës mund të përdoren në mënyra të tilla që sjellin përvoja kuptimplota të përkatësive politike dhe shoqërore për njerëzit e të gjitha moshave, sfoneve dhe perspektivave, në të tashmen.

Për shkaqe burimore, ky përkthim nuk është i përfunduar. Nuk përmban diskursin mbi historitë e vështira dhe muzeve dhe debatet në hapësira publike, dhe disa nga shembujt më të gjatë të ofruar. Ky është simboli që nënkupton se teksti është lënë mënjanë - (...). Teksti i plotë në anglisht mund të gjendet në ueb-faqen e New Perspektiva-s për historinë shumëperspektivëshe të Kosovës:

<http://multi-perspektiva.com/wp-content/uploads/2020/03/Difficult-Histories-Positive-Identities-report-web.pdf>

Fusnotat e përfshira në tekst mund të gjenden në linkun në anglisht. Ato gjenden në anën e majtë të çdo faqeje. Në fund të tekstit gjendet një bibliografi e plotë.

Shpresojmë që ju ka pëlqyer leximi jo vetëm si mësues por edhe si njerëz me interes të gjerë në histori dhe në të menduarit e hapur, sidomos ju që keni përjetuar dhe dëshmuar konfliktet jo aq të largëta në Ballkan.

Joanna Hanson,
Drejtoreshë Ekzekutive e *New Perspektiva-s*

Historitë e Vështira dhe Identitetet Pozitive

Përmbledhje ekzekutive

Nuk ka ndonjë mënyrë të vetme për ta parë të kaluarën dhe për t'i jetësuar në të tashmen mësimet historike: kërkimi historik kontestohet sepse ne hulumtojmë të kaluarën nëpërmjet këndvështrimit të tanishëm, të ravigjësuar nga një diversitet botëkuptimesh, vlerash dhe qëndrimesh aktuale. Njerëz dhe grupe të ndryshme përjetojnë historinë në mënyra të ndryshme, dhe lënë pas tyre gjurmë të llojllojshme arkivore dhe materiale. Ky raport shtjellon hulumtimin dhe të menduarit mbi qëndrimet ndaj një aspekti të caktuar të “historive të vështira”, dhe pasojave të tyre për identitetet britanike.

Viteve të fundit, trashëgimitë komplekse të konfliktit dhe imperializmit kanë kanalizuar debatet rreth asaj se si vendet, grupet dhe njerëzit adresojnë dimensionet sfiduese të së kaluarës. Qasja për zgjimin e një të kaluarë supozimisht kolektive për të arsytuar veprimet në të tashmen, çon në rezultate të kontestuara, duke përfshirë mënyrat se si popullsitë diskutojnë mundësitë e një ndjenje të përbashkët të identitetit dhe të përkatësisë.

Raporti përvijon nevojën për t'u përballur me të kaluarën në një mënyrë më të sinqertë dhe më të hapur, sepse një studim kritik i së kaluarës na mundëson përdorimin e aspiratave dhe shpresës për një shoqëri paqësore, të hapur dhe përfshirëse. Megjithatë, ky proces mbart edhe rreziqe, përfshirë dhe shqetësimin dhe injorancën. Historikisht, ka pasur përjashtime ekskluzive nga analiza historike, të cilat kanë hapur dallimet në atë se cilat histori interpretohen dhe nga kush. Mbase sfida kyçe e qasjes ndaj “historive të vështira” qëndron në baraspeshimin e narrativave të ndryshme me qasje dhe pjesëmarrje, e tërë pjesa e së cilës kërkon një proces të rivizitimit të së kaluarës për të lëvizur drejt të ardhmeve më të mira.

Pjesa I e Historive të Vështira dhe Identiteteve Pozitive shpërfaq se si një qasje e “historive të vështira” mund të përdoret si strategji për mësim dhe angazhim (emocional) nëpër mjedise si shkolla, hapësira publike dhe muze, dhe përmes aktivizmit apo fushatave për paqe dhe pajtim. Rastet e studimit si: fushata #RhodesMustFall, mësimi i “historisë së vështirë në klasat në Britani të Madhe, apo përvoja gjermane Vergangenheitsbewältigung pas Luftës së Dytë Botërore dhe Holokaustit, pasqyrojnë angazhime kombëtare dhe ndërkombëtare me të kaluarat problematike dhe me përgjigjet ndaj tyre.

Pjesa II e raportit ndan reflektime ndërsektoriale dhe rekomandime praktike për intervenim dhe ndryshim pozitiv. Ajo vë theksin në rëndësinë e përzgjedhjes së historive të caktuara mbi të tjerat dhe rëndësinë për të cilësuar se për kë është e vështirë tema e zgjedhur.

Të gjeturat kryesore përfshijnë:

- “Historitë e vështira” ndikojnë në proceset përmes të cilave formohen identitetet në të tashmen, me ndikime që variojnë nga marginalizimi i grupeve të ndryshme deri në shmangien e fshirjes apo harrimit të së kaluarës.
- Mënyrat se si institucionet dhe narrivat formësojnë të kuptuarit tonë të së kaluarës si përvojë kolektive, duke ndërtuar një nocion të vetëdijes historike, ndikojnë në ndjenjën tonë të përkatësisë shoqërore dhe të identitetit (kombëtar).
- Një qasje e “historive të vështira” ndaj së kaluarës ofron një mënyrë për t'u kundërvënë miteve kombëtare të thjeshta (dhe potencialisht kufizuese apo edhe përjashtuese), duke vepruar në kundërshtim me “historinë e rehatshme.”

- Angazhimi me “historitë e vështira” kërkon vullnet për t’u marrë me “jorehatinë”, dhe përkushtim të barabartë nga edukatorët apo nxënësit, për të ndryshuar apo për të prekur perspektivat ekzistuese.
- Të merresh me të kaluarën nga ky këndvështrim më kritik nënkupton të jesh më i hapur për të shtruar pyetje alternative dhe për të përfshirë perspektiva të fshehura. Kjo mund të ndihmojë një shoqëri që të ndryshojë se si mësohet historia dhe çfarë shkruhet për të – dhe, rrjedhimisht, që t’i bëjë narrativat historike më përfshirëse.
- Vendimi për të përcaktuar histori të caktuara si “të vështira” mund të çojë në një binom të bazuar në vlera apo të thjeshtëzuar, i cili përjashton dimensionet e tjera të një angazhimi domosdoshmërisht të ndërlikuar me të kaluarën.
- Aktivitetet inovative ndërsektoriale, siç janë programet e partneritetit ndërmjet muzeve dhe shkollave, ofrojnë një mënyrë për të kërkuar lloje të reja dhe të ndryshme të angazhimit të publikut me temën.

Ky raport thekson rëndësinë e marrjes së një qasjeje ndërsektoriale për “historitë e vështira”, duke nxjerrë inpute nga politikëbërësit, academia, arsimi, praktikat trashëgimore, dhe një sërë palësh rëndësishme të interesit në komunitet.

A ka rëndësi historia?

Identiteti kombëtar dhe historia kritike

Në kontekstin britanik, trashëgimitë ideologjike të së kaluarës sonë kanë formuar temën e një diskutimi të madh në dekadat e fundit. Shumë prej këtyre bisedave janë zhvilluar brenda domenit publik dhe medieve kryesore. Politika qeveritare udhëzon shkollat, universitetet, muzetë dhe trupat e tjerë publikë që të reagojnë, të rikthejnë dhe të ripërfaqësojnë të kaluarën e një popullsie që është gjithnjë e më shumë heterogjene në kategoritë shoqërore, etnike dhe fetare. Në një shoqëri të llojllojshme në rritje e sipër, kuptimet e historisë ndikojnë se si grupe të ndryshme identifikojnë veten dhe përjetojnë një ndjenjë përkatësie.

Qeveritë, njerëzit dhe komunitetet përdorin historinë si mjet për të mbajtur dhe formësuar identitetet. Mirëpo aty ku kuptimet e shkuara të së kaluarës më nuk bashkëzërojnë me vlerat shoqërore, perspektivat e historisë kritike thërrasin për rivlerësim. Shumica e historive përfshin elementet e tragjedisë, të dhunës a të padrejtësisë, dhe qasjet e “historive të dhimbshme” kërkojnë të njohin këto dhe, si përgjigje, të promovojnë ndryshime pozitive për kurrikulat, kurimin dhe hapësirat e historisë publike.

Por pyetja se çfarë është ky interpretim më i ndërlikuar i historisë, dhe se si jehon (dhe si duhet të mësohet) në këtë vend, ende kontestohet. Si e prek zgjerimi i njohurive tona të së kaluarës ndjenjën tonë të përkatësisë dhe mënyrën se si i paramendojmë vetë lidhjet tona me komunitetin, vendin dhe kombin?

Definimi i historisë

“Historia mund të bëhet nga akademikët në universitete, nga kuratorët në muze, nga hulumtuesit në medie, nga historianët e familjeve, nga historianët të pavarur lokalë që punojnë për veten apo për

autoritetet lokale, apo nga njerëzit që janë të interesuar në një hapësirë të caktuar dhe fillojnë të zbulojnë me mënyrat e veta” (Moody, 2015: 114-115).

Në kuptimin më të gjerë, historia ka të bëjë me përfaqësimin e së kaluarës. E kaluara asnjëherë nuk zgjidhet, prandaj përshkrimet e rëndësishme të asaj që ka ndodhur më herët prodhohen (dhe riprodhohen) shoqërisht sipas konteksteve të caktuara hapësinore, kohore, shoqërore, politike dhe kulturore (Hobsbawm, 1998; Jordanova, 2000; Cannadine, 2002; Tosh, 2015). Për historianin David Cannadine, “historia e bën të sheshtë kompleksitetin dhe pasigurinë e çështjeve njerëzore dhe vargun dhe llojllojshmërinë e përvojës njerëzore (Cannadine, 2008: 5). Ajo ekziston si subjekt për përdorim dhe keqpërdorim nga njerëz, grupe dhe kombe (Macmillan, 2009; Evans, 2001). Në nivelin kombëtar, narrativat historike shpërndahen nëpërmjet vendeve zyrtare të sanksionuara nga shteti. Siç përmendet hollësisht në këtë raport, vendet dhe narrativat funksionojnë në tandem për t’u dhënë legjitimitet rreshtimeve bashkëkohore politike, duke ruajtur, rrjedhimisht, interesat e grupit mbizotërues. (Connerton, 1989; Wertsch, 2000).

...”[H]istoria e bën të sheshtë kompleksitetin dhe pasigurinë e çështjeve njerëzore dhe vargun dhe llojllojshmërinë e përvojës njerëzore (Cannadine, 2008: 5).

Historianët akademikë kanë përgjegjësi profesionale për ta treguar të kaluarën si diçka që nuk është e njëanshme apo e thjeshtë, por si shumëfaqëshe dhe komplekse. Nëpërmjet pyetjeve, ata përdorin dëshmitë përgjegjësisht dhe sistematikisht. Ata (duhet të) ndërtojnë argumente dhe të shpërndajnë analiza të rrumbullakësura të cilat janë të afta për të ndriçuar mendësinë e gjeneratave të kaluara (Wertsch, 2002). Por gjithmonë ekziston një rrezik që ata të mund të ndjekin gjykimet e veta apo animet politike në përzgjedhjen dhe paraqitjen e materialeve, si dhe në nxjerrjen e përfundimeve.

Duke pyetur dhe sfiduar vazhdimisht perspektiva të ndryshme, historianët kontribuojnë drejt diskurseve të vazhdueshme dhe në ndryshimin e të kuptuarit rreth së kaluarës (Moody, 2015: 125). Përkundër miteve të thjeshta nacionaliste, ata kërkojnë të shtojnë thellësi objektive, si dhe të ndriçojnë dilemat morale të së kaluarës (Cannadine, 2013). Angazhimi me këto çështje është komponent jetik për të ndihmuar një shoqëri që të merret me historitë konfliktuale, si një mjet për të kapërcyer tensionet shoqërore, paragjykimin dhe ndarjen.

Historia brenda kujtesës dhe bumi trashëgimor

Konceptimi i historisë si subjekt në izolim po ndryshon dalëngadalë. Rritja e Studimeve të Kujtesës dhe Studimeve të Trashëgimisë, fjala vjen, ka mjegulluar vijat tradicionale disiplinore. Për shembull, trashëgimia definohet gjerësisht si komercializimi dhe komodifikimi i së kaluarës, diçka që mund të performohet në ambiente për konsum nga audienca masive (Ashworth et al., 2007). Tani ajo shihet si element thelbësor i pronësisë dhe i përkatësisë si formë e identitetit.

...trashëgimia definohet gjerësisht si komercializimi dhe komodifikimi i së kaluarës, diçka që mund të performohet në ambiente për konsum nga audienca masive (Ashworth et al., 2007).

Nga një pikëvështrim i Studimeve të Kujtesës, grupet dhe njerëzit shprehin kujtesën për të nxitur vetveten që të ndërtojnë forma të përbashkëta të identitetit. Kujtesa shoqërore është koncept që hulumton lidhjet mes identitetit shoqëror dhe kujtesës historike (French, 1995). Njohuritë dhe rëndësia e së kaluarës shoqërore mbahen nëpërmjet kujtesës shoqërore, me narrativa të përdorura për të përcjellë përvojat e së kaluarës (Halbwachs, 1992; Cubitt, 2007; Assmann, 2012).

Për historianin Dipesh Chakrabarty, kujtesa është bërë produkt i tregtueshëm për median (Chakrabarty, 2000, 2007), dhe kjo ka rastisur me një lëvizje drejt përfshirjes në kulturën popullore të kujtesave paraprakisht të fshehura. Përmes kapacitetit të saj për t’i dhënë nuanca të kaluarës, kujtesa

mundëson: “një mënyrë të bindjes që është e përnjëhershme dhe e cila i flet horizontit kohor demokratik të “së tashmes”, në kontrast me disiplinën e këmbënguljes së gjatë të historisë mbi logjikën e bindjes, që kërkon procesin konsumues të kohës, të mbledhjes së dëshmimeve si provë për një argument që sheh drejt horizontit kohor të “ende jo-së”” (Attwood, 2011: 171).

Sfera e “historive të vështira”

“Historitë e vështira” formojnë një fije të ndërlidhur të disiplinave historike gjatë diskutimeve nëpër debate përgjatë dhe ndërmjet sektorëve dhe ndarjeve akademike. Profesionistja e muzeve Julia Rose, ka propozuar motivimet e mëposhtme për adresimin e “historive të vështira” si histori të heshtura apo të harruara (2016: 50–51):

- Avokimi
- Qytetaria
- Përkujtimi
- Krijimi i kujtesave
- Krijimi, mbajtja dhe ndryshimi i identiteteve
- Shfaqja e respektit
- Edukimi
- Vajtimi
- Nderimi
- Të shpresuarit
- Informimi
- Inspirimi për veprim kritik, avokim dhe përmirësim shoqëror
- Inspirimi i empatisë
- Udhëzimi
- Brenga morale për të tjerët
- Motivimi i hulumtimeve
- Ofrimi i kërkimfaljes
- Ofrimi i dëmshpërblimeve
- Edukimi për paqe
- Mundësimi i zgjidhjeve frymëzuese
- Mundësimi i afirmimit shoqëror
- Ngritja e tensioneve për të mësuar
- Të kujtuarit
- Të kujtuarit e drejtësisë së dhembshur
- Ripërtëritja e kujtesave
- Zgjidhja
- Të mësuarit e drejtësisë shoqërore
- Puna për reminishencë terapeutike
- Përligjja e kuptimeve të vizitorëve apo sfidimi i kuptimeve
- Paralajmërimi kundrejt dhunës së ardhshme
- Puna përmes vuajtjes

Zbulimi, zgjerimi dhe ngritja e historive të dhimbshme dhe qëmoti të heshtura kërkon riadresimin e narrativave mbizotëruese historike. Sidoqoftë, interpretimi nuk është pa rreziqe, si në nivelin personal, ashtu edhe në atë politik. Për profesionistët e historisë, ekziston një kusht për të shmangur mosndjeshmërinë dhe provokimin e panevojshëm. Në të vërtetë, organizatat mund të dëshmojnë rezistuesë për të vënë në pikëpyetje kujtesën kolektive të një historie të vlerësuar, veçanërisht kur kjo mund të rrezikojë humbjen e financimit.

Nuk duhet të jetë i befasishtëm fakti se nxënësit e “historive të vështira” reagojnë. Ata që thithin njohuri të reja (sidomos përbrenda ambientit të një muzeu) mund të ndjehen fajtorë, të çuditur, të hutuar, të zemëruar, të shokuar apo të turpëruar. Ata mund të kenë një ndjenjë faji apo dhembshurie për vuajtjen e të tjerëve (Sontag, 2003). Mirëpo këtu qëndron misioni eksplicit i “historive të vështira”: për të promovuar dialogun dhe hulumtimin e mëtejshëm, duke nxjerrë kuptime të reja nëpërmjet të kuptuarit të ndryshëm të ngjarjeve të kaluara (Simon et al., 2000). Si një bazë për të ndryshuar mënyrën se si e shohim botën dhe për të reflektuar mbi realitetin shoqëror, kjo mund të inkurajojë përgjigje më të efektshme për padrejtësitë e tanishme dhe për ndarjet lokale a kombëtare.

... misioni eksplicit i “historive të vështira”: për të promovuar dialogun dhe hulumtimin e mëtejshëm, duke nxjerrë kuptime të reja nëpërmjet të kuptuarit të ndryshëm të ngjarjeve të kaluara (Simon et al., 2000)

Sado që është retrospektiv dhe nuk përfshin rreziqe, interpretimi dhe mësimi i “historive të vështira” është ndërmarrje shpresuese. Demonstrimi se si historitë ndikojnë në shoqërinë bashkëkohore është një mënyrë e re e ridefinimit të asaj se si mësojmë për të kaluarën. Një shkëmbim i qëndrueshëm ndërmjet nxënësve dhe interpretimit autoritativ ofron shpresë për reflektim në të ardhmen dhe një shans për të shëruar plagët e përzgjatura.

Historia dhe formimi i identitetit në shkolla

Ligjërimi dhe të mësuarit e historisë

Ligjërimi dhe të mësuarit rreth historisë mund të jenë të vështira. Brenda një ambienti edukues, historia është lëndë e përgatitur për të nxitur ndryshimin të rinjtë (Simon, 2005; Hopkins, 2010). Në radhë të parë, kjo është falë fuqisë së arsytimit historik. Të mësuarit rreth së kaluarës ndihmon në zhvillimin e aftësive individuale të domosdoshme për pyetje objektive kritike (bie fjala, studimi i dëshmisë dhe të kuptuarit e implikimeve të paragjyqimeve). Ky lloj pyetjesh përgatitë studentët për të vlerësuar rëndësinë historike, duke gjurmuar ndikimet e ndryshimeve a ngjarjeve mbi njerëzit, grupet dhe kombet. Një bindje e tillë tregon se qytetarët e rinj do të jenë në pozitë më të mirë për të kuptuar vendin e tyre në botë, dhe për të reflektuar mbi përgjegjësitë që ta formësojnë të ardhmen, duke studiuar historinë.

Të mësuarit rreth së kaluarës ndihmon në zhvillimin e aftësive individuale të domosdoshme për pyetje objektive kritike (bie fjala, studimi i dëshmisë dhe të kuptuarit e implikimeve të paragjyqimeve). Ky lloj i pyetjeve përgatitë studentët për të vlerësuar rëndësinë historike, duke gjurmuar ndikimet e ndryshimeve a ngjarjeve mbi njerëzit, grupet dhe kombet.

Në shtator të vitit 2014, në Angli hyri në fuqi një Kurrikulë e re Kombëtare për Shkollat. Kurrikula e Historisë mori shumë inspektim, i cili pasoi vendimet e diskutueshme nga Sekretari i atëbotshëm i Arsimit, Michael Gove, që perceptoheshin gjerësisht si përzgjedhje e narrativave triumfale të “tregimit ishullor” të Britanisë për një agjendë nacionaliste e konservatore (Mansell, 2013). Pati debate dhe kritika rreth promovimit të identitetit britanik si diçka që, në më të mirën, pastronte – dhe, në më të keqen, shlyente – trashëgimitë e së kaluarës perandorake.

Pasojat e këtyre debateve shtruan nevojën për diskutim rreth riparimit të historisë dhe të identitetit britanik, me referencë të veçantë për rolin e bashkësive shumëkulturore, të migrimit dhe të “historive të fshehura”. Përballja me “historitë e vështira” i shton kompleksitet funksionit tradicional të historisë brenda shtet-kombeve moderne, i cili ishte që të mbante një kuptim kolektiv të një të kaluarë të bashkërenduar (Gross dhe Terra, 2018b). Siç vë në dukje Knauer-i dhe Walkowitz-i, “shqyrtimet postkoloniale të racës dhe të identitetit kombëtar ekzistojnë në tension të pandalshëm me nocionet befasisht të durueshme moderniste të një shtet-kombi të bashkuar” (Knauer dhe Walkowitz, 2009: 2).

Përballja me “historitë e vështira” i shton kompleksitet funksionit tradicional të historisë brenda shtet-kombeve modern, i cili ishte që të mbante një kuptim kolektiv të një të kaluarë të bashkërenduar (Gross dhe Terra, 2018b).

Britania e Madhe ka shënuar përparim drejt të mësuarit të historive më të ndryshme nëpër klasa, si rezultat i narrativave që vënin në pikëpyetje aspekte të caktuara të së kaluarës kombëtare të vendit (Cannadine et al., 2011). Ligjërimi i këtyre historive të jorehatshme duhet të cilësohet si “një mënyrë për të krijuar një temë që angazhon të gjithë nxënësit, në mënyrë që të përgatitë fëmijët për jetë si të rritur në Britaninë shumëkulturore” (Alexander et al., 2015: 3).

Sido që të jetë, me kurrikulën tashmë të rishikuar, dhe koherenca e saj e gjithësisht duke qenë prioritet kyç, shqetësimi mbetet se si ta pasurojmë atë që të pasqyrojë një sërë etnicitetesh, sfondesh dhe nacionalitetesh (Alexander et al., 2012; Mohamud dhe Whitburn, 2014; Heath, 2018). Janë parashtuar pyetje rreth një çekuilibri ndërmjet narrativave “të rehatshme” dhe “sfiduese” (posaçërisht në lidhje me marrëdhëniet me ish-Kolonitë Britanike), dhe rreth shkallës deri te cila historitë po përdoren për të ndriçuar çështjet bashkëkohore shoqërore. Për mësuesit pas Fazës Kyçe 2 (Pas Klasës IX, moshë 14) kërkohet edhe një akt organizues, kur përpiqemi që të nxisim të kuptuarit e vërtetë, kundruall madhështise së padyshimtë të fitimit të njohurive të kërkuara për vlerësim formal.

“Historitë e vështira” në klasë: mësuesit

“Studimi i historisë mund të jetë emotiv dhe tendencioz aty ku ka padrejtësi të vërtetë apo të perceptuar kundrejt njerëzve nga individit apo grupit tjetër në të kaluarën...aty ku ka kundërshtitë ndërmjet asaj çka mësohet në historinë në shkollë, në historinë në familje/komunitet dhe në historitë e tjera. Çështje të tilla dhe kundërshtime krijojnë një jehonë të fortë me studentët në mjedise të caktuara edukative” (Wrenn et al., 2007: 4).

“Historitë e vështira” janë hulumtuar gjerësisht në fushën e Studimeve Arsimore, me hapësira të shënuara të shqetësimit, duke përfshirë “të kaluarat e ndjeshme”, marginalizimin e grupeve dhe ambicien e pajtimit (shih Cole, 2007; McCully, 2012; Zembylas, 2015; Van Boxtel et al., 2016). Kjo ka ilustruar rëndësinë e çështjeve pedagogjike në bërjen e temës të përshtatshme për publikun në klasë. Mësuesi (ose edukatori) është rojtari në ndarjen e informacionit, që kërkon t'i mundësojë klasës të përballë me temën kolektivisht dhe pastaj të gjurmtojë drejt një pikëpamjeje të re.

Mësuesi (ose edukatori) është rojtari në ndarjen e informacionit, që kërkon t'i mundësojë klasës të përballë me temën kolektivisht dhe pastaj të gjurmtojë drejt një pikëpamjeje të re.

“Historitë e vështira” ngjallin emocione të ndryshme në klasë. Përgjigjet ndaj njërit apo tjetrit janë parakusht për progres, megjithëse këto ndryshojnë sipas identiteteve kulturore dhe lidhjeve të të rinjve të përfshirë (Jonker, 2012; Epstein dhe Peck, 2018; Metzger dhe Harris, 2018). Pritshmëria në sfidimin e besimeve ekzistuese mund të jetë gjithashtu problematike për mësuesit. Individët mund të ndjehen të shqetësuar apo të pasigurtë në rolin e tyre lehtësues, për shkak të jehonës aktuale të temës, në potencialin për përgjigjet e ngarkuara emocionalisht, apo në kapërcimin e pikëpamjeve të ngushta të identitetit. Kur përdorin diskutimin si mënyrë për adresimin e çështjeve kundërthënëse, ata mund të ndjehen të paaftë apo pamjaftueshmërisht të përgatitur që të intervenojnë duke sfiduar besimet apo duke kontrolluar reagimet e paparashikueshme (Hand dhe Levinson, 2012; Kello, 2016; Zembylas, 2017). Ngjitur me këtë është edhe nevoja për njohuri të hollësishme të temës – një burim që nuk është gjithmonë lehtësisht i qasshëm.

Në vitin 2007 është autorizuar një raport nga Asociacioni Historik (i përkrahur nga Departamenti për Arsim dhe Aftësi) për të planifikuar detajisht rezistencën potenciale ndaj ligjëritit të “historive të vështira” dhe praktikën e mirë për të. Në këtë raport, Wren et al. kanë ekzaminuar ligjërimin e “Historisë Emotive dhe Kundërthënëse” në grupmoshat 3-19. Ata shqyrtojnë një numër rastesh

studimi, si “Britania dhe Tregtia me Skllevër”, dhe ligjërimin e çështjeve emotive rreth historisë së myslimanëve. Janë bërë rekomandime të ndryshme që sot mbesin të përshtatshme:

- Dhënia e vëmendjes mësuesve fillestarë dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional (CPD).
- Nëpërmjet temave dhe qëndrimeve të planifikuara, duke siguruar që ligjërimi është “një çështje e tërë shkollore dhe jo një aspekt i adresuar sporadikisht përmes temave individuale”.
- Inkurajimi dhe udhëzimi i mësuesve kur bëhet fjalë për përmirësimin e ligjërimin, përfshirë udhëzime mbi debatin dhe ndërmarrjen e rreziqeve kur përballen me sfida të jashtme nga prindërit dhe komunitetet.
- Përmirësimi i llojit dhe i cilësisë së burimeve dhe bazës së dëshmive të disponueshme, për të mundësuar një kurrikulë më të llojllojshme dhe më të rëndësishme (Wrenn et al., 2007: 41–42).

“Historitë e vështira” në klasë: nxënësit

Për vetë nxënësit, narrativat personale shpesh përdoren brenda “historive të vështira”. Ato janë të dizajnuara të frymëzojnë identifikimin, dialogun dhe empatinë emocionale si strategji angazhuese për të kuptuar. (Watson, 2016; Nordgren, 2017). Disa kanë vënë në pikëpyetje dimensionet e tyre morale, duke sugjeruar që prezentimit të historive përfshirëse përmes identiteteve individuale mund t’i mungojë pluraliteti më i gjerë. Kjo mund t’i parandalojë të rinjtë të marrin distancë kritike, përtej ndonjë kufizimi praktik siç është madhësia e klasës (Nordgren dhe Johansson, 2015; Van Boxtel et al., 2016). Megjithatë, ky qëndrim është një mënyrë efektive e preferuar nga profesionistët për të fituar një tablo dhe për të lehtësuar përballjen me të kaluarën e një kombi.

Një qëndrim veçanërisht i njohur ka qenë përdorimi i historive familjare dhe i tregimeve të migrimit që janë drejtpërsëdrejti të nxjerra nga burimet dhe të hulumtuara nga të rinjtë.

Një qëndrim veçanërisht i njohur ka qenë përdorimi i historive familjare dhe i tregimeve të migrimit që janë drejtpërsëdrejti të nxjerra nga burimet dhe të hulumtuara nga të rinjtë. Për shembull, projekti “Bërja e Historive”, që përfshin 210 studentë nga kolegjet, shkollat e mesme dhe akademitë, trajnuan të rinjtë për të ndërmarrë intervista të historisë gojore në Leicester, në Sheffield dhe në Cardiff. Kjo nismë kërkonte të stimulonte interesin individual në historitë sociale, të komuniteteve dhe të familjeve, duke pasqyruar historitë e ndryshme lokale të Britanisë. Më tej, gjatë viteve 2014-2018, një varg projektesh edukuese janë ndërmarrë në Britani për të përkujtuar njëqindvjetorin e Luftës së Parë Botërore. Shpeshherë duke përfshirë ambiente përreth (bie fjala, një memorial lokal i luftës), disa ngjarje dhe aktivitete janë lidhur me materialin kurrikular, teksa të tjerat ishin aktivitete jashtëkurrikulare me partnerë të komunitetit – por të gjitha ato u mundësuan nxënësve për të shtruar pyetjet e tyre.

Rezultatet e dëshiruara nga iniciativa të tilla janë dyfaqëshe: nxënësi kontekstualizon tregimet individuale brenda periudhës më të gjerë historike, dhe pastaj iu qaste kësaj për të kuptuar (dhe për të pyetur) ndërlikimet e së kaluarës. Në vend të grumbullimit të pastër të njohurive, të kuptuarit e tillë është sipëror në përballjet me “historitë e vështira” në klasë (Segall, 2014; Pearce, në vijim).

(...)

E kaluara në të tashmen: kontestimi i narrativave historike

Shembujt vijues tregojnë se si historitë dhe kujtesat e kontestuara përfshijnë edhe përpjekje, edhe ndryshim, duke dëshmuar se si leximi i vendeve mund të ndryshojë përgjatë kohës:

- Një artikull në ueb-faqen e BBC News-it kërkon të ngrisë vetëdijen publike të faktit se si rrugët më të njohura në qendrën e qytetit të Glasgow-it janë emëruar sipas skllavopronarëve të shek. XVIII, të cilët bënë pasuritë e tyre përmes plantacioneve të duhanit (BBC, 2018c).
- Në vitin 2017, National Trust [Organizatë britanike që mbron vendet historike, peizazhet dhe natyrën] filloi një program tematik të quajtur “Historitë Sfiduese”. Ky program hulumton më shumë aspekte të fshehura dhe histori të shpërfillura të pronave të tyre anembanë Britanisë së Madhe, nëpërmjet ekspozitave, ngjarjeve dhe rrëfimeve. Përgjatë vitit 2019, ai shqyrtoi hapësira ku njerëzit kanë luftuar për të shprehur dhe për të kontestuar të drejtat e tyre politike dhe shoqërore (National Trust, 2019).
- Në mes të përkujtimeve për njëqindvjetorin e Luftës së Parë Botërore, grupi “Ensuring We Remember” lloboi suksesshëm për krijimin e një memoriali kombëtar në Londër për nder të 96,000 vullnetarëve të Korpusit Kinez të Punës (Ensuring We Remember, 2019).
- Në Parkun Hyde të Londrës, Memoriali i Komandës Mbretërore të Forcave Ajrore ishte vandalizuar në janar të vitit 2019, për të katërtën herë brenda gjashtë viteve (BBC, 2019).

(...)

Ekzistojnë disa të përbashkëta ndërmjet katër këtyre shembujve:

1. Të gjithë ata përvetësojnë vajtimin si mënyrë për të pyetur të kaluarën dhe për ta përdorur atë që të shfaqë efekt.

Duke bërë paralajmërim për atë se çfarë mund të ndodhë apo se çfarë tashmë ka ndodhur, “historitë e vështira” parashohin se çfarë mund të rindodhë apo të vazhdojë (Black, 2014: 139). Të gjithë këta shembuj ndërtojnë historitë “publikisht të qasshme” që janë tregues të një interesi të madh të përgjithshëm në të kaluarën dhe të angazhimit me të (shih Ashton and Kean, 2012). Historiani Jay Winter ka sugjeruar që kjo histori publike është ndërlidhur me një “bum të kujtesës” që ka çuar më tej prezentimet e së kaluarës në mjediset dhe në formatet publike, siç janë vendet historike, seritë televizive dhe materiali online (Winter, 2007). Një kufi i ndryshueshëm ndërmjet historianëve amatorë dhe profesionalë ka paraprirë dhe ngritur interesin në rikthimin e tregimeve të viktimave. Përqafimi i historive të fshehta më marginale tenton të ndërlikojë perceptimet kryesore. Një vëzhgim i tillë mund të kuptohet si mënyrë e qasjes së “historive të vështira” – një mundësi për të zgjidhur përjashtimin, qoftë i qëllimshëm a i paqëllimshëm. Për më tepër, historia publike mund të formësojë aktivisht se si e kaluara përfaqësohet në hapësirat publike, kur bazohet në audienca të parapara.

Siç shpjegojnë Knauer dhe Walkowitz:

“Shumë shpesh, politikanë, profesorë dhe profesionistë të tjerë i referon “publikut” si të ishte një masë e bashkuar dhe homogjene me një tërësi të vetme vlerash dhe interesash. Në shoqëritë shumëracore dhe shumëkulturore, raca, klasa, gjinia dhe statusi qytetar, mes shumë faktorëve, formësojnë investimin e individëve në marrëdhënie me sferën publike – duke përfshirë debatet për vendet e historisë publike. Është ndoshta më e saktë dhe e dobishme për të ideuar publikun e shumë me interesa divergjente dhe shpeshherë garuese dhe pjesë të ndryshme në atë se si përfaqësohen historitë” (Knauer and Walkowitz, 2009: 3).

2. Ata janë të lidhur nga përdorimi i tyre i përkujtimeve, në një formë a në një tjetër.

Përkujtimi është akti simbolik i njohjes dhe nderimit të kujtimit të dikujt apo të diçkaje nëpërmjet udhëzimit të organizuar kolektiv. Memorializimi funksionon si shtysë simbolike për të njohur episode dhe figura të caktuara nga historia. Ai mund të jetë zyrtar apo jozyrtar – ky i fundit do të përfshinte murale të krijuara në pjesë të mureve nga lagjet protestante dhe katolike në Belfast. Më së

rëndësishmi, aktiviteti përkujtues kërkon një audiencë. Çfarëdo mesazhi që jepet, duhet të jehojë me vlerat dhe të kuptuarit e atyre që e marrin atë. Kjo e vë atë në tension me edukimin sepse ajo çka komunikohet mund të mbyllë kuptime alternative, nëpërmjet riafirmimit (në vend të riadresimit) të narrativave historike.

3. Secili prej tyre ka përdorur praninë e platformave që mund të nxisin ndryshim me anë të përfshirjes së masave dhe të përkrahjes (së zakonshme).

Aftësia për të ndërvepruar dhe për të folur në shkallë të rëndësishme (përmes mjeteve të medieve sociale) mund të bashkëzërojë me lëvizjet e fushatave dhe të mbulimit medial për të krijuar interesa të mëdha publike dhe momentum për veprim.

(...)

“Historitë e vështira” brenda Gjermanisë

Pesha grumbulluese e së kaluarës së afërt të Gjermanisë ka gjetur shumë akademikë tek sodisin përvojat e shtetit pas viteve 1945 dhe 1990. (Niven, 2002; Rosenfeld dhe Jaskot, 2008; Schroeder, 2013; Peitsch dhe Sayner, 2015; Nießer dhe Tomann, 2018; shih edhe McGuinness, 2019). Me rindërtimin e kishës së saj Frauenkirche, e përfunduar më 2005, ka pasur një fokus të madh në Dresden si simbol i pajtimit të pasbashkimit, me të kaluarën (për shembull, shih Fuchs, 2012; Joel, 2012; Rehberg dhe Neutzner, 2015).

Paraprakisht, dhe bazuar në hulumtimet e gjera në atë se si qyteti i Nuremberg-ut është marrë me trashëgiminë naziste, puna e antropologjistit kulturor Sharon MacDonald, “Trashëgimia e Vështirë” ka kontribuar shumë në të menduarit rreth njohjes publike të mizorive të kaluara në vend (Macdonald, 2009, 2015). Në kontrast me trashëgiminë afirmative identitare (e cila kërkon të përçojë triumfe dhe sakrifica), puna e MacDonald-it vlerësoi se si identitetet bashkëkohore negociohen dhe formësohen në faqen e përkujtuesve ashpërsisht të dukshëm dhe konkretë të arkitekturës naziste, veçanërisht përmes ndërkëmbimit të shpërfilljes, të identitetit, të kujtesës dhe të harrimit. MacDonald-i drejtoi “Trashëgiminë e Vështirë” si një e kaluar që është kontestuese dhe e pakëndshme për pajtim publik, por është një gjë që mbetet kuptimplotë në të tashmen (Macdonald, 2009: 1). Ajo çfarë shpërndan është një mesazh më i gjerë edukues rreth nevojës për “pavendosmëri të vazhdueshme” (Macdonald, 2009: 192).

[Sharon] MacDonald-i drejtoi “Trashëgiminë e Vështirë” si një e kaluar që është kontestuese dhe e pakëndshme për pajtim publik, por është një gjë që mbetet kuptimplotë në të tashmen (Macdonald, 2009: 1)

Kombinimi gjerman i përkujtimit, i pajtimit dhe i rikonstruktimit ka shtyrë ngjashëm sociologun Jeffrey Olick për të reflektuar: “Politika e keqardhjes është një zhvillim përgëzues, diçka e re në histori; dhe ndikimi i saj i vazhdueshëm në Gjermani dhe gjetiu duhet të festohet...[R]asti gjerman...është shembulli ynë më i mirë se pse është e rëndësishme lufta për trashëgiminë e së kaluarës, rreth përgjegjësisë së prindërve dhe të trashëgimit të fëmijëve” (Olick, 2016: 468).

Si një transformim më i gjerë socio-kulturor, njohja e krimeve të së kaluarës apo e keqbërjeve nga vendi i dikujt, është bërë mbizotëruese dhe e ndërkombëtarizuar. Më tej, nga (disa) qeveri ajo vlerësohet si aset pozitiv për identitetin bashkëkohor kombëtar. Për Gjermaninë, mbajtja e përkujtuesve të dukshëm të keqbërjeve, me pasojat e gjata për të ardhmen, ngre pjesë të filozofisë së njohur si “Vergangenheitsbewältigung”, apo “pranimi/përballja me të kaluarën” (shih Mueller, 2010). Kjo prek dyanshëm zotërimin dhe procesimin e së kaluarës, në mënyrë që një individë ta çlirojë veten nga ndikimi negativ dhe potencialisht destruktiv.

Për Gjermaninë, mbajtja e përkujtuesve të dukshëm të keqbërjeve, me pasojat e gjata për të ardhmen, ngre pjesë të filozofisë së njohur si “Vergangenheitsbewältigung”, apo “pranimi/përballja me të kaluarën” (shih Mueller, 2010).

(...)

Paqja, pajtimi, dhe identitetet pozitive

Një qasje e “historive të vështira” ngrit potencialin për të punuar përmes të kaluarave të rënda si mënyrë kuptimplotë për të parashtruar pyetje rreth së ardhmes sonë kolektive. Megjithëkëtë, me rritjen e ekstremizmit, migrimit dhe zhvendosjeve të popullsisë përgjatë Evropës, historive dhe trashëgimisë po u bëhet gjithnjë thirrje që të mbajtur identitetet rajonale dhe kombëtare (Mink, 2013). Kjo po lejon që të lulëzojnë jotoleranca dhe mosbesimi. Me klimën aktuale politike të pasigurtë dhe turbulente, Britania e Madhe nuk bën përjashtim.

...me rritjen e ekstremizmit, migrimit dhe zhvendosjeve të popullsisë përgjatë Evropës, historive dhe trashëgimisë po u bëhet gjithnjë thirrje që të mbajtur identitetet rajonale dhe kombëtare (Mink, 2013). Kjo po lejon që të lulëzojnë jotoleranca dhe mosbesimi.

Bërja e paqes me të kaluarën

Sidoqoftë, përdorimi i trashëgimisë kulturore me narrativa të historisë së ndërlikuar dhe të jorehatshme mund të forcojë përkushtimin për mësim për dialog dhe për ndërtimin e paqes. Disa profesorë, megjithatë, kanë shtruar një kundërgument, duke pyetur nëse është detyrë jona morale që të kujtojmë të kaluarën – sado e dhimbshme apo ndarëse mund të jetë ajo – dhe duke pohuar që përpjekjet për të ndërtuar paqe vetëm mund të riprodhojnë konflikt (Murphy, 2010). Komentuesi dhe shkrimtari David Rieff ka propozuar që, meqenëse përkujtimi kolektiv mund të jetë toksik, dhe kujtesa historike e abuzuar, më morale është që të harrohet (Rieff, 2016; see also Forty, 1999).

Tema e të harruarit si diplomaci është diçka që mund të marrë rëndësi transnacionale. Historiani Joan Beaumont shpjegon se si kampi Changi i të Burgosurve të Luftës në Singapor është rrënuar më 2004, për shkak të kërkesave për zhvillim lokal (Beaumont, 2019). Përkundër rëndësisë së vendit si vend i kujtesës për identitetin austrian në Luftën e Dytë Botërore, vendimi është marrë për të ndjekur një qasje të “harrimit” sesa të “keqardhjes” nëpërmjet ruajtjes. Jeremy Black ka kontempluar mbi këtë dilemë:

“Bërja e paqes me historinë” shihet si mënyrë për të lehtësuar një të ardhme paskoloniale, veçanërisht për t’u përballur me presionet e multikulturalizmit, për të adresuar të drejtat e njerëzve, dhe për të bërë të mundshëm transnacionalizmin...E shikuar ndryshe, bartja e përgjegjësive përgjatë gjeneratave si mënyrë për të “shëruar” të kaluarën mund të shërbejë shumë për përsëritjen e mbajtjes zi. Për më tepër, ideja propozon një histori publike që është çorientuese sepse ofron një narrativë pajtuese, me politizim të ndërlidhur” (Black, 2014:189).

Hughes dhe Kostovicova janë ngjashëm të frikësuar ndaj opsionit të “amnezisë kombëtare” në njërin anë të spektrit, kundrejt alternativës së të qenët “një gjendje e përhershme gërryese të kontestimit të së kaluarës dhe të përndjekjes së sjelljes së kaluar, varësisht nga barashpesha politike e pushtetit të një kohe të caktuar” (Hughes dhe Kostovicova, 2018: 623; shih edhe Salter dhe Yousuf, 2016; Termin dhe Dahl, 2017). Mënyra se si nevoja për të kujtuar garon me nevojën për të harruar, krijon një sfidë të vërtetë për pajtim dhe qasje për drejtësi transnacionale.

Mënyra se si nevoja për të kujtuar garon me nevojën për të harruar, krijon një sfidë të vërtetë për pajtim dhe qasje për drejtësi transnacionale.

Përpyjekja për paqe: “historitë e vështira” dhe narrativat e paqes

Është e dukshme që komunitetet e ndara bartin përvoja të kundërta të së kaluarës, duke përmendur plagët historike për të krijuar ndjenja të dhimbjes, të mosbesimit dhe të urrejtjes. Lëvizja drejt një kornize të pajtimit përfshin përqafimin e një besimi se e kaluara mund të kuptohet ndryshe. Kjo lejon që të arrihen mësimet thelbësore, duke hapur kështu mundësi për të ndërtuar një të ardhme më paqësore (shih Bekerman dhe Zembylas, 2012; McConnell dhe Braniff, 2014; Zembylas et al., 2016). Një shembull i kërkimfaljes pajtuese ndodhi në Australi në shkurt të vitit 2008, kur qeveria zgjodhi të bëjë një pranim formal të padrejtësive ndaj popullsisë vendëse aborigjine (BBC, 2008).

Lëvizja drejt një kornize të pajtimit përfshin përqafimin e një besimi se e kaluara mund të kuptohet ndryshe. Kjo lejon që të arrihen mësimet thelbësore, duke hapur kështu mundësi për të ndërtuar një të ardhme më paqësore (shih Bekerman dhe Zembylas, 2012; McConnell dhe Braniff, 2014; Zembylas et al., 2016).

Përmes nismave si Koalicioni Ndërkombëtar i Vendeve të Ndërgjegjes, Instituti për Drejtësi Historike dhe Pajtim (IHJR), Rrjeti Ndërkombëtar i Muzeve për Paqe, dhe puna e vazhdueshme e OJQ-ve dhe muzeve, ndërtimi i paqes njihet si një mënyrë për të transformuar qasjet e të mësuarit ndaj trashëgimisë së të kaluarave të rënda. Një shembull i kësaj ka qenë puna e OJQ-së së pavarur Trashëgimia Kulturore pa Kufij. Kjo organizatë kërkon të shpëtojë dhe të ruajë trashëgiminë kulturore të prekur nga lufta, nga neglizhenca apo nga fatkeqësia njerëzore dhe natyrore, për pajtim, duke punuar gjerësisht në Ballkan.

(...)

Si proces, pajtimi përfshin njohjen e së kaluarës, para vlerësimit se si duhet të kujtojmë padrejtësitë historike apo ndarjet që dalin nga ajo. Pajtimi është vazhdimisht i pranishëm brenda debateve akademike dhe të politikave mbi ndërtimin e paqes pas luftërave, anipse ky vështrim e ka emëruar atë tejet dykuptimësh dhe të stërpolitizuar (Hughes dhe Kostovicova, 2018: 622). Të menduarit e kohëve të fundit ka avokuar pajtimin si një dukuri ndërsidiplinare hapësinore, i aftë për intervenim në ndreqjen e marrëdhënieve të thyera shoqërore mbi pajtimin si dekolonizim (Giblin, 2014; Björkdahl dhe Buckley-Zistel, 2016; Harrowell, 2017; shih edhe Rouhana, 2018).

Kushti thelbësor qëndron në menaxhimin e historisë së vështirë të një të kaluarë konfliktuale, për të rritur ndërtimin e paqes për të ardhmen.

Si proces, pajtimi përfshin njohjen e së kaluarës, para vlerësimit se si duhet të kujtojmë padrejtësitë historike apo ndarjet që dalin nga ajo.

Klima bashkëkohore ka mbajtur një momentum për mekanizmat e bazuar institucionalë dhe të bazuar në profesionistët për të kërkuar rezultatet e drejtësisë shoqërore dhe të përvojave transformuese. Edhe pse pjesërisht rreth vënies në pikëpyetje të të vërtetave të marra për të mirëqena dhe shpërfaqjes së luftërave, ndjekja e “historive të vështira” është padyshim ndërmarrje optimiste dhe shpresëdhënëse. Agjendat e saj përfshijnë diskutimin e hapur dhe bisedat e lira rreth padrejtësive të kaluara, si mënyrë për të ecur përpara.

(...)

Temat kyçe

Në shkurt të vitit 2019, konferenca e Cumberland Lodge-it, “Historitë e Vështira & Identitetet Pozitive”, diskutimet në tavolinat e rrumbullakëta dhe prezentimet e të ftuarve silleshin rreth katër temave kyçe, secila prej të cilave zbulonte sfida që janë të rëndësishme për t’u përgjigjur “historive të vështira”, dhe shqyrtonin rekomandimet për praktika të ardhshme.

Temat kyçe ishin: shqetësimi; ligjërimi brenda shkollave; Holokausti si “histori e vështirë” dhe menaxhimi i së kaluarës së afërt brenda Gjermanisë, si dhe muzetë dhe ndërtimi i paqes.

Shqetësimi

Ata që merren drejtpërdrejt me “historitë e vështira”, duhet të jenë rehat me ndjenjën e shqetësimit. Shpeshherë, tema është thelbësisht problematike, me fuqinë e të rënit jashtë narrativave të njohura të krijuara. Në vend se të jetë pengesë, megjithatë, një pozicion i mospajtit apo i “shqetësimit” duhet të veprojë si ndihmë e frytshme për të nisur dialogun. Inkorporimi i kundër-narrativave, apo nxitja e provokimit të qëllimshëm, janë mënyra të zgjerimit të horizonteve për të vënë në pikëpyetje kuptimin e së kaluarës. Zhvillimi i të kuptuarit është paraprijës për një praktikë më të përgjegjshme dhe të përbashkët historike – duke lehtësuar një histori tërësisht më të informuar dhe përfshirëse që më mirë pasqyron shoqërinë tonë bashkëkohore dhe të ndryshme.

Duke pranuar që pikëpamja jonë për të kaluarën është e përzgjedhur dhe përzgjedhëse, ata që punojnë për të prezentuar “historitë e vështira” mund të identifikojnë praktikën e tyre të përditshme si tregimi i historisë së njëjtë ndryshe. Njohja e kompleksitetit ose joharmonisë – në vend të rrëfimit të së kaluarës në binome të thjeshta “e mirë” kundër “e keqe” – i bën “historitë e vështira” një mekanizëm pozitiv për të menduar. Përmendja e narrativave të marginalizuara mund të ofrojë hapësirë për të treguar tregime më pak të njohura, duke rinegociuar, kështu, supozimet e sotme rreth asaj se kush mendojmë se jemi.

(...)

Ligjërimi brenda shkollave

Rëndësia e historisë formësohet mbizotërueshëm nga mësuesit (dhe eksponentë të tjerë) si një çështje e rëndësishme arsimore: edukimi i mirë historik ndihmon për të bërë qytetarë më të përgjegjshëm. Trajnimi historik përfshin kërkimin dhe studimin e dëshmisë si aftësi kryesore, por po ashtu mësimin për të zhvilluar perspektiva historike nga tregime garuese. Hulumtimi i fokusuar në grupe, i ndërmarrë nga Shoqëria Mbretërore Historike hodhi në dritë një apetit të fortë të nxënësve për temën; megjithë kohën e kufizuar të kontaktit, mendjet e reja ishin të entuziazmuara nga mundësia për të kuptuar kompleksitetin e së kaluarës (Royal Historical Society, 2018a).

Mësuesit dhe organizatat e mësuesve kanë publikuar punë të rëndësishme gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, jo vetëm duke teorizuar praktikën klasore, por edhe duke ravijëzuar ndërveprimin përbërës të historisë ndërmjet përmbledhjes dhe thellësisë (p.sh. Davies, 2017). (...) Synimet fisnike të mësuesit

shpeshherë mbingarkohen nga presionet administrative, nga rangimet tabelare dhe nga provimet. Disa edukatorë mbrojnë një lidhje brenda shkollave në përvetësimin e një kulture menaxheriale dhe të modeleve të trupave për ekzaminimin e testeve – duke u bërë presion mësuesve të historisë që të praktikojnë metodat e shkathëtisë GCSE, dhe që të ndjekin detyra të thjeshtëzuara të bazuara në burime, në dëm të përmbajtjes së pasur.

Në korrik të vitit 2019, Runnymede Trust [Runnymede është trupi kryesor profesional, i pavarur dhe për barazi racore, në Britani të Madhe] (në partneritet me TIDE-n [Udhëtimi, Transkulturalizmi dhe Identiteti në Angli rreth viteve 1550-1700] në Universitetin e Liverpool-it) i bëri thirrje qeverisë britanike për ta bërë obligative në shkollat e mesme ligjërimin e historive të ndërlidhura të perandorisë dhe të migrimit. Duke vërejtur që vetëm 4% e nxënësve që hyjnë në testet e GCSE-së [anglisht: General Certificate of Secondary Education] për histori zgjedhin lëndën opsionale “Migrimi në Britani”, raporti nënvizoi që, megjithëse këto tema tashmë figurojnë brenda rubrikës së kurrikulës së Historisë dhe Anglishtes, shumë shkolla janë penguar nga burimet e kufizuara të teksteve shkollore.

Një gatishmëri për të ligjëruar “historitë e vështira” krijon një varg sfidash logjistike dhe konceptuale, veçanërisht një peshë pritshmërie mbi mësuesit për t’i bërë temat ndërvepruese, të rëndësishme dhe angazhuese.

Hapat për ndryshim përfshijnë:

- Rishikimi i fokusit të kurrikulës së Historisë në shkollat e mesme për të mbuluar lëndë më të gjera. Studimi i më pak temave në detaje mund të pasurojë nxënësit dhe mësuesit, përmes ndihmës për kuptim procesual, teksa qartëson mirënjohjen e nxënësve dhe praktikën e argumentit historik. Praktika e kombinimit të studimit të përvojës individuale me shumëperspektivitet, shërben si instrument për zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik, të parashtrimit të pyetjeve, dhe të analizës.
- “Dekolonizimi i kurrikulës, për ta bërë atë më përfshirëse. Adresimi i lëndëve perandorake si Copëzimi i Indisë apo Varfëria e Bengal-it mund të korrigjojë një mungesë relative të mbulimit etnik brenda disiplinës. I dëshirueshëm është edhe një kryqëzim më i madh me lëndë bazike shtesë, përmes avancimit të bashkëpunimeve ekzistuese mes departamenteve ndërmjet Letërsisë Angleze dhe Historisë, rreth temave specifike ndërkurrikulare (fjala vjen, novela feministe utopike “Ëndrra e Sulltanës” nga Rokeya Sakhawat Hossain-i ose novela e Sebastian Barry-t e vitit 2005, “Një Rrugë e Gjatë, e Gjatë”, rreth Irlandës gjatë Luftës së Parë Botërore).
- Dhënia e vëmendjes kurrikulare një ndjenje lokale të vendit. Njohja, afiniteti dhe urgjenca e çështjes korresponduese (bashkë me vendet lokale dhe me tregimet e përfaqësuesve të njerëzve të atyre të përfshirë në ngjarje historike), do t’u mundësonte nxënësve për të vënë në pikëpyetje tregime më të gjera në nivel nacional. Kjo mund të nënkuptojë prezentimin e fëmijëve të vegjël me historinë jo përmes kronologjisë, por duke u fokusuar në historisë konkrete dhe praktike të komuniteteve.
- Ofrimi i lehtësirave më të mira për trajnim/përkrahje për zhvillimin të vazhdueshëm profesional për mësuesin, CPD (prioritizimi i historisë, CPD specifike, sesa më të përgjithshme apo CPD e bazuar në teste), përkrah përmbushjes së kërkesave për trajnim të edukimit historik që u mundëson mësuesve individualë që të përballen efektivisht dhe ndjeshmërisht me temat e vështira (p.sh. metodologji/burime të reja për të punuar me një trup të ndryshëm studentor dhe për t’u marrë konstruktivisht me mospajtimet).
- Ndërtimi i modeleve të suksesshme për të dhënë pëmbajtje angazhuese e inovative për tema specifike – zhvillimi i iniciativave si skema National Teaching Fellowship e Asociacionit Historik, Programi i Shkollave të Trashëgimisë i Historic England-it (financuar nga Departamenti për Arsim) dhe përvoja me mësues, të paraqitura në Konferencën e përvitshme “Schools History Project”.

- Alokimi i përkrahjes financiare për të mundësuar inpute nga kontribuesit si: ligjëruesit universitarë, kuratorët e muzeve apo punëtorët e komuniteteve, ose ndërveprimet kreative ndërdisiplinare. Përkrahja e jashtme për programet sy më sy dhe burimet e qasshme online nënvizuan përfitimet e ndihmës së jashtme.

Këto sugjerime lidhen me shqetësimet për financim. Pamjaftueshmëria e vullnetit politik dhe mungesa e përkrahjes për burimet klasore rrezikon krijimin e një kulture “mbaje atë që di” ndërmjet mësuesve në presion të kohës, si dhe një qasje “e shtyrë nga forca” ndaj dijes, duke vënë theksin në recitim prej nxënësve të infomacioneve të mësuar brenda mjediseve testuese. Rrjedhimisht, thirrja që historia jo vetëm që duhet ta mbajë funksionin e saj si mundësuese e njohurive, por edhe të inkurajojë një ndjenjë të përbashkët të qytetarisë, përmes një narrative të fortë nacionale, duke njohur që “historia jonë e përbashkët është bërë më e pasur dhe më e ndryshme. Ajo është e gatshme që të angazhohet me viktimat dhe me fituesit” (Stannard, 2019).

Pamjaftueshmëria e vullnetit politik dhe mungesa e përkrahjes për burimet klasore rrezikon krijimin e një kulture “mbaje atë që di” ndërmjet mësuesve në presion të kohës, si dhe një qasje “e shtyrë nga forca” ndaj dijes, duke vënë theksin në recitim prej nxënësve të infomacioneve të mësuar brenda mjediseve testuese.

Ndryshimi i demografisë së klasave bën që të rinjtë BAME [shkurtesë për: Black, Asian and minority ethnic] përbëjnë 27% të shkollave fillore dhe të mesme të financuara nga shteti në Angli dhe në Uells (Weale, 2019). Është thelbësore që edukimi historik të japë një kuptim më integruar dhe më të plotë të identitetit britanik, të origjinave të tij dhe të kontestimeve. Zhvillimi i instrumenteve për të menduarit kritik, në tandem me konsensusin e gjerë për një kurrikulë më të llojllojshme të historisë, do të inkurajonte një reflektim më të shëndetshëm rreth elementeve të nënadresuara të këtij tregimi kombëtar.

Ligjërimi i “historive të vështira mund të kontribuojë aktivisht drejt një shoqërie më të orientuar në debat: një që u lejon individëve të shohin vetveten brenda historive që ligjërohen. Mediet sociale formësojnë atë se si të rinjtë konsumojnë informacionet dhe si u përgjigjen temave. Protestat e fundit për ndryshimet klimatike, të udhëhequra nga të rinjtë, ilustrojnë vullnetin e të rinjve për të kërkuar ndryshime politike. Nxjerrja e lidhjeve ndërmjet së kaluarës dhe ngjarjeve aktuale mund të avancojë të kuptuarit: për shembull, rikonsiderimi i Revolucionit Industrial si fillimi i një krize ekologjike, apo i ngrohjes globale, e parë me sytë e industrializimit. Nëpërmjet teknologjisë digjitale, gjeneratat e ardhshme mund të paraqesin pikëpamjet e tyre për “historitë e vështira” dhe të formësojnë debatet (virtuale) rreth asaj se si e portretizojnë identitetin, duke përdorur të kaluarën për t’u marrë me sfidat e së tashmes.

Ligjërimi i “historive të vështira mund të kontribuojë aktivisht drejt një shoqërie më të orientuar në debat: një që u lejon individëve të shohin vetveten brenda historive që ligjërohen.

Holokausti si “histori e vështirë” dhe menaxhimi i së kaluarës së afërt brenda Gjermanisë

Holokausti ka qenë i pranishëm në silabusin e Kurrikulës Kombëtare të Historisë që nga viti 1991. Gjersa është studiuar dhe ligjëruar për dekada të tëra në Britani të Madhe, në vitet e fundit ka pasur një interes të ripërtëritur me shuarjen e pashmangshme të dëshmitarëve okularë, dhe me kalimin gradual nga kujtesa e gjallë në histori. Zhdukja e dëshmitarëve të dorës së parë të të mbijetuarve rastis me një keqkuptim të Holokaustit dhe me rritjen e anti-semitizmit brenda Britanisë së Madhe (Sherwood, 2019; “Debat paneli: Kujtesa Publike e Luftës së Dytë Botërore dhe Holokausti”, YouTube, 2019). Ka edhe shqetësime se Memoriali i Holokaustit në Britani të Madhe, që do të

vendoset në Uestminster, rrezikon përhapjen e një narrative shpëtimtare rreth asaj se si Britania zgjedh të kujtojë përfshirjen e saj me Holokaustin (Moore (Bob), 2019; Moore (Rowan), 2019). Retorika bashkëkohore për Luftën e Dytë Botërore, si një kohë kur Britani “qëndroi e vetme”, përçon njëkohësisht një narrativë të fuqishme të Britanisë sikur përballet me një “outsider” që kërcënon vlerat. Një kuptim i tillë inkurajon një ndjenjë të fortë kombëtare dhe një ndjenjë të përkatësisë për disa, apo jep një përgjigje për pasigurinë bashkëkohore që mban mosbesim, diskriminim dhe zhgënjim për të tjerët (Walker, 2019; Montlake, 2019).

Prioritizimi se cilave fusha të historisë u jepet rëndësi brenda debateve dhe pyetjeve të diskursit nëse duhet një fokus i madh në Holokaust, i zhvendos paqëllimshëm episodet e tjera “të vështira” në historinë britanike. Një pikëpamje që duket të ketë fituar popullaritet, megjithëse jo përkrahje universale, është e nevojës për debate më të hapur rreth asaj nëse Holokausti është bërë deri diku një temë “e sigurtë” për ta adresuar nën sferën e “historive të vështira”.

Kundërshtarët kontestojnë këtë argument të afërsisë dhe të pranimit të supozuar, duke bërë thirrje për intervenime edukative që u përgjigjen sfidave dhe pengesave të këtij peizazhi të ri – fjala vjen, për ta konceptualizuar dhe për t’u marrë me temën në vetëm një ose dy orë të mësimit të bazuar në shkolla. Megjithëkëtë, ballafaqimi me këtë dije sjell kuptim të fuqishëm në ndjenjën e përkatësisë së një njeriu, dhe përfshin një përgjegjësi për ta sfiduar të tashmen përmes veprimit individual – një prioritet që përfaqëson memorialin më të mirë për të ardhmen.

Profesionistët dhe njerëzit me ndikim në Britani të Madhe mund të shohin të përdorin rastin e studimit të Gjermanisë, në mënyrat që janë ballafaquese dhe penduese për të kaluarën e vet të vështirë. Jo vetëm që migrimi i pasluftës ka sjellë një publik më të llojllojshëm, por Gjermania është bërë edhe kampione e lehtësimit të forumeve për debat të brendshëm – për shembull, debati Historikerstreit mes akademikëve në vitet 1986-1989 që u përqendrua në përcaktimin e njëjesisë së Holokaustit. Përpyekjet e përkushtuara, në formën e hulumtimit historik dhe të edukimit për historinë kritike, janë kanalizuar në Gjermani si instrumente kujtimi për kapërcimin e trashëgimive të kaluara. Prapëseprapë, kur bëhet fjalë për kujtimet e ish-Republikës Demokratike Gjermane (GDR), ka mungesë pajtimi. Brenda rajoneve lindore të Gjermanisë, disa grupe dhe mbrojtës tentojnë t’u rezistojnë tentimeve për të historicizuar në mënyre kritike regjimin socialist si dhe të kaluarën naziste. Rezultatet janë pakësimi i dialogut ndërmjet gjeneratave, faji i përbrendësuar dhe rritja e pasigurisë se si brezat e ardhshëm mund të ndërveprojnë me trashëgimitë historike. Grupet dhe partitë populiste në Gjermani ilustrojnë një nevojë për zhvillimin e koncepteve përkujtimore për periudha të ndryshme historike. Është interesante se ky debat qëllon me dhënien 93 milionë Eurove në maj të vitit 2019 për restaurimin e Pikave Grumbulluese të Partisë Naziste në Nuremberg. Ndryshimi nga një fazë arkitekturore të një turpërim arkeologjik, ka sjellë një shkallë mbylljeje të një kokëçarjeje të gjatë të ruajtjes së vendeve, të konservimit apo të shkatërrimit. Vendimi për të zgjedhur restaurimin jep shenja për një qasje të ballafaqimit dinamik dhe menaxhimit të këtij komponenti të së kaluarës së Gjermanisë si shteg për përmirësim moral.

(...)

Rekomandime

Përfaqimi i “historive të vështira” kërkon përkushtim të qëndrueshëm nga ana e qeverive, edukatorëve dhe nxënësve, për të promovuar ndryshim kuptimplotë, në mënyrë që të mundësohet angazhim më i madh dhe që të ngriten perspektivat ekzistuese ndërmjet publikut të gjerë. Identifikimi i gabimeve të së kaluarës – dhe marrja e përgjegjësisë për t’i përmirësuar pasojat e veprimeve të gabuara – është hap pozitiv drejt korrigjimit të padrejtësive sociale në të tashmen.

Me kë po përpiqemi t'i angazhojmë “historitë e vështira”

“Historitë e vështira” pasqyrojnë shqetësimet shoqërore dhe kulturore. Ato mund të ndikojnë në shoqërinë si të tërë përkrah nëngrupeve të veçanta. Pjesëtarët e grupeve minoritare mund të ndjehen të zhgënjyer rreth lidhjes me narrativat e shumicës që janë në konflikt me përvojat e veta. Nismat për të shqyrtuar të kaluarën, që përfshijnë zëra të marginalizuar dhe për të bërë bashkë njerëz nga sfonde të ndryshme, mund t'u ndihmojë individëve të rilidhen me komunitetet e tyre.

Angazhimi konstruktiv me tema kundërthënëse, përmes nismave kulturore për publikun, nënkupton ballafaqimin haptazi me një varg audiencash. Masat që flasin për fuqizimin e komuniteteve janë të arritshme.

Rekomandimet tona janë:

- Krijimi i “hapësirave të sigurta” për shkëmbim bisedash rreth “historive të vështira”, që nënvizojnë nevojën për të pranuar dallimet dhe bashkëpunimin ndërsektorial (p.sh. ndërmjet OJQ-ve dhe organizatave të sektorit publik). Bashkëpunimi i suksesshëm do të mbështetet në objektiva të qartë, siç është marrja e përgjigjeve konstruktive mbi idetë, pa frikën e pasojave.
- Priorizimi i kompletimit institucional të kornizave të analizave të palëve të interesuara, si masë praktike demografike për të shqyrtuar nevojat e grupeve të ndikuara nga intervenimet e ardhshme. Ky hap mund t'i paraprijë krijimit të një Bordi Këshillimor të Komuniteteve, përfaqësimi kolektiv dhe konsultimi i të cilit forcon proceset vendimmarrëse për organizatat ballafaqese me publikun.
- Bërja e qasshme e të gjeturave të bazuara në praktikë dhe instrumenteve (për mësim online) për qarkullim më të gjerë (p.sh. përmes një biblioteke burimore online) për organizatat e largëta që mund të përfitojnë nga qasja.
- Bashkëkoordinimi i fushatave në medie sociale që mundësojnë biseda online, për t'i frymëzuar individët në praktikën e tyre ditore dhe për të lehtësuar lidhjet përgjatë kufijve shoqërorë.

Cilat “histori të vështira”?

Është jetike lidhja e “historive të vështira” me saktësinë hulumtuese, në një kohë kur ekspertiza e historianëve kërcënohet nga keqinformimi nëpër medie sociale. I njohur ndërkombëtarisht, Instituti për Drejtësi Historike dhe Pajtim po zhvillon iniciativa të kornizave shumëpalëshe për të udhëzuar përgjigjet diplomatike kundrejt çështjeve kontestuese historike. Mirëpo, teksa grupet angazhohen në mënyra të ndryshme me trashëgimitë e së kaluarës, ekziston një nevojë urgjente për të kuptuar më mirë ndikimin e përzgjedhjes së historive. Bërja e një zgjedhjeje për të përkujtuar shënon një ngjarje nga jeta e përditshme. Sidoqoftë, promovimi i përkujtimit edukativ të një të kaluarë sesa të një tjetre mund të dalë si dëmtues dhe ndarës, kur komunitetet provojnë të dallojnë vetveten përmes narrativave garuese të viktimësisë. Vetëdefinimi i dikujt si viktimë kërkon deklaram të veçantisë, duke vlerësuar lloje të ndryshme të përvojave. Viktimësia mund të largojë përgjegjësinë për veprim në të tashmen; disa i shohin masat dëmshpërblyese si rforcim i marrëdhënieve të fuqisë ndërmjet viktimës dhe fituesit historik, dhe “më shumë i ndan sesa i pajton” (Jenkins, 2018b: 285). Për më tepër, “historitë e vështira” nuk shndërrohen (domosdoshmërisht) në “histori të lehta” – rezoluta është proces i vazhdueshëm i palëve të ndryshme të interesit.

Rekomandimet tona janë:

- Përmirësimi i bashkëkoordinimit ndërmjet nismave aktualisht të pavarura të “historive të vështira” me tërë organizatat.

- Krijimi i një platforme të mundshme që planifikon të menduarit e bashkuar dhe vlerat e përbashkëta me rastet e studimit (p.sh. duke vendosur raportet e arritjeve në një vendruajtje kombëtare)
- Hulumtimi i më shumë praktikave aktive nga iniciativa të krahasueshme ndërkombëtare, të cilat përqendrohen në të kaluarat sfiduese (të afërta apo të tjera).